

PLANI I KONSOLIDUAR I ANGAZHIMEVE SPECIFIKE NË TREGTINË E SHËRBIMEVE TË PALËVE TË CEFTA-s

SHËNIME SHPJEGUESE

Ky "Plan i konsoliduar i angazhimeve specifike në tregtinë e shërbimeve të palëve të CEFTA-s" bazohet në listën e Kombeve të Bashkuara për Klasifikimin Qendror të Produktit (CPC) që përdoret në negociatat e shërbimeve në Organizatën Botërore të Tregtisë, por gjithashtu përfshin disa shërbime siç përshkruhet në versionin 2 të CPC (Botimi i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

Ky plan është në përputhje me praktikën e orarit të GATS dhe tregon vetëm ata sektorë dhe nën-sektorë shërbimesh në të cilët Palët po ndërmarrin angazhime. Në lidhje me angazhimet për qasjen në treg dhe trajtimin kombëtar, mënyrat e ndryshme të furnizimit të treguara në plan, janë si më poshtë:

Mënyra 1: nga territori i një Pale në territorin e çdo Pale tjetër;

Mënyra 2: në territorin e një Pale te një klient shërbimi i çdo Pale tjetër;

Mënyra 3: nga një furnizues shërbimesh i një Pale, nëpërmjet pranisë komerciale në territorin e çdo Pale tjetër; dhe

Mënyra 4: nga një furnizues shërbimi i një Pale, nëpërmjet pranisë së personave fizikë të një Pale në territorin e çdo Pale tjetër.

Për qëllime të këtij plani, atëherë kur angazhimet ndërmerren nga të gjitha palët në CEFTA 2006, kjo tregohet me shënimin "Të gjitha Palët e CEFTA-s". Përndryshe, angazhimet nga palët individuale tregohen më poshtë me shkurtesat në vijim, në rendin e listuar në preambulën e CEFTA 2006, por duke përjashtuar Palët që janë tërhequr nga Marrëveshja në përputhje me nenin 51.

Pala 1 – PI

Pala 2 – PII

Pala 3 – PIII

Pala 4 - PIV

Pala 5 – PV

Pala 6 – PVI

Pala 7 – PVII

A. ANGAZHIMET HORIZONTALE

1. Blerja e tokës dhe pasurive të paluajtshme

PI – Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër nuk mund të blejnë burime natyrore dhe toka bujqësore, pyje ose toka pyjore në pronësi të shtetit ose toka në zonat kufitare dhe ushtarake në **PI**. Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër kanë të drejtë të blejnë tokë jo-bujqësore në pronësi shtetërore, me kusht që vlera e investimit në tokën në fjalë të jetë tre herë më e lartë se vlera e tokës jo-bujqësore në **PI**.

PII – Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër nuk mund të blejnë dhe të zotërojnë pasuri të paluajtshme në **PII**, përveç nëse prona e blerë ndërlidhet me furnizimin e një shërbimi dhe me kushtin e reciprocitetit midis PII dhe Palës ku personi fizik ose juridik banon ose është i themeluar sipas ligjit. Toka bujqësore nuk mund të jetë në pronësi të personave fizikë ose juridikë të një Pale tjetër.

PIII – Personi fizik ose juridik i një Pale tjetër me kusht të reciprocitetit midis PIII dhe Palës ku personi fizik ose juridik banon apo është themeluar, mund të fitojë të drejtën e pronësisë së banesave, ndërtesave dhe lokaleve afariste, dhe të drejtën e pronësisë ose qirasë afatgjate të tokës ndërtimore në territorin e **PIII**. Personi fizik ose juridik i një Pale tjetër mund të marrë të drejtën e qirasë afatgjate të tokës bujqësore në territorin e **PIII**, me kushtin e reciprocitetit midis PIII dhe Palës ku personi fizik ose juridik banon ose është themeluar sipas ligjit. Qiratë afatgjate nuk mund të kalojnë nëntëdhjetë e nëntë (99) vite. Për të gjitha blerjet nevojitet miratimi i ministrive kompetente.

PIV – Qiraja e tokës që nuk kalon nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet është e lejuar. Personat fizikë ose juridikë të një Pale tjetër mund të blejnë tokë në **PIV** përveç tokës bujqësore ose pyjore.

PV – Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër mund zotërojnë pasuri të paluajtshme në **PV**, përveç tokës bujqësore dhe pasurive të paluajtshme brenda zonave të kufizuara.

PVI – Toka bujqësore nuk mund të jetë në pronësi të personave fizikë ose juridikë të një Pale tjetër. Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër nuk mund të blejnë dhe të kenë pasuri të paluajtshme në **PVI** përveç nëse prona e blerë është e lidhur me ofrimin e një shërbimi dhe me kusht të reciprocitetit ndërmjet PVI dhe Palës ku personi fizik ose juridik banon ose është i themeluar sipas ligjit. Qiratë e tokës nuk mund të kalojnë nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

PVII – Personat fizikë dhe juridikë të një Pale tjetër mund të fitojnë të drejta në pasuri të paluajtshme në **PVII**, përveç nëse me ligj parashikohet ndryshe (kufizime jo diskriminuese). Kufizimet zbatohen për tokën bujqësore dhe tokën pyjore.

2. Lëvizja e kapitalit

PIII – **PIII** mban të drejtën për të mbajtur kufizimet në lidhje me operacionet e depozitave rezidente dhe operacionet e kapitalit rezident, lidhur me investimet në pasuri të paluajtshme dhe fondet jashtë vendit.

3. Regjistrimi i kompanive

Të gjitha palët e CEFTA-s – Zyra Përfaqësuese është pjesë e një kompanie dhe nuk ka status të personit juridik. Zyrat e tilla mund të angazhohen vetëm në hulumtime të tregut, aktivitete promovuese ose përfaqësuese. Ato nuk mund të kryejnë aktivitete tregtare.

PII – Në fushat e medias (televizioni, radio, gazetat), tregtisë dhe prodhimit të armëve, eksplozivëve dhe pajisjeve ushtarake, përqindja e kapitalit të huaj nuk duhet të jetë më shumë se dyzet e nëntë (49) për qind.

PVI - Personi fizik ose juridik i një Pale tjetër nuk mund të ketë pronësi shumicën në ndërmarrjet që merren me tregtinë e armëve dhe municionit, ose në ndërmarrjet e themeluara në zonat e kufizuara (të tilla si brezin kufitar, parqet kombëtare, zonat ushtarake) dhe duhet të ketë miratimin e ministrisë kompetente për investime në raste të tilla. Personat fizikë ose juridikë të një Pale tjetër mund të krijojnë ose të investojnë në ndërmarrje të tilla vetëm me një person të brendshëm, pas plotësimit të kërkesës së lartpërmendur.

4. Shërbimet publike

Të gjitha palët e CEFTA-s:

Shërbimet që konsiderohen si shërbime publike në nivel kombëtar ose lokal mund të jenë subjekt i monopolit publik ose i të drejtave ekskluzive që u jepen operatorëve privatë. Këto mund të ekzistojnë në fushat e mëposhtme: shërbimet e energjisë; uji; shërbimet e transportit publik dhe shërbimet ndihmëse për të gjitha llojet e transportit; shërbimet e konsulencës shkencore dhe teknike; shërbimet kërkimore dhe zhvillimore në shkencat sociale dhe humanitare; shërbimet e testimit dhe analizës teknike; shërbimet mjedisore; shëndetin publik dhe shërbimet sociale publike; shërbimet e komunikimit dhe shërbimet e arsimit publik. Të drejtat ekskluzive për shërbime të tilla mund t'u jepen operatorëve privatë kombëtarë ose lokalë në baza preferenciale.

5. Prania e personave fizikë

Të gjitha palët e CEFTA-s përveç PV:

Pa kufizim, përveç masave lidhur me hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm të kategorive të mëposhtme të personave fizikë që ofrojnë shërbime: personeli kyç (vizitorët e biznesit, të transferuarit brenda korporatës); pjesëmarrësit në trajnim; shitësit e shërbimit të biznesit; furnizuesit e shërbimeve kontraktuale; profesionistë të pavarur; dhe vizitorët afatshkurtër për qëllime biznesi, siç përcaktohet në Shtojcën 1 të Protokollit Shtesë 6 mbi Tregtinë e Shërbimeve.

PV:

Me qëllim të zbatimit të angazhimeve të saj sipas Shtojcës 1 të Protokollit Shtesë 6 mbi Tregtinë e Shërbimeve, **PV** nuk mund të kërkojë të drejtat dhe detyrimet e saj gjatë një periudhe tranzicioni prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokollit për **PV**. Gjatë asaj periudhe tranzicioni, **PV** do të zgjerojë angazhimet e mëposhtme për praninë e personave fizikë në të gjitha Palët e CEFTA-s në baza reciproke.

PV merr përsipër të lejojë hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në territorin e saj të kategorive të mëposhtme të personave fizikë:

(i) Të transferuarit brenda korporatave (ICT)

Hyrja dhe qëndrimi për një maksimum prej 3 vjetësh i jepet personave të transferuar brenda një korporate dhe filialeve dhe degëve të saj, të cilët:

- (a) Kanë qenë të punësuar nga një person juridik i themeluar në një Palë tjetër për të paktën një vit menjëherë para datës së hyrjes;
- (b) Janë transferuar përkohësisht në kontekstin e ofrimit të një shërbimi në **PV**, në një filial ose degë që ofron shërbime në **PV**; dhe
- (c) Janë menaxherë, ekzekutiv ose specialistë, siç përcaktohen më poshtë.

Menaxherët: janë persona që punojnë në një pozitë të lartë, që kryesisht e drejtojnë personin juridik, duke përfshirë (a) drejtimin e ndërmarrjes, departamentit ose nënndarjes së ndërmarrjes; (b) mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë mbikëqyrës, profesional ose menaxherial; dhe, (c) që kanë autoritetin që të punësojnë dhe shkarkojnë personalisht ose të rekomandojnë punësimin, shkarkimin ose veprimet e tjera të personelit (të tilla si autoriteti për ngritje në pozitë ose pushim), dhe të ushtrjnë autoritet diskrecional mbi operacionet e përditshme. Nuk përfshihen mbikëqyrësit e linjës së parë, përveç nëse punonjësit e mbikëqyruar janë profesionistë, dhe nuk përfshihen punonjësit të cilët kryesisht kryejnë detyra të domosdoshme për ofrimin e shërbimit. Nuk do të kërkohet testi i nevojave ekonomike.

Ekzekutivët: janë persona në kuadër të personit juridik, të cilët kryesisht drejtojnë menaxhmentin e personit juridik, përcaktojnë qëllimet dhe politikat e personit juridik, ushtrjnë liri të gjerë në vendimmarrje, dhe marrin vetëm mbikëqyrje të përgjithshme ose udhëzime nga drejtuesit e nivelit të lartë, bordi i drejtorëve ose aksionarët e personit juridik. Ekzekutivët nuk do të kryejnë drejtpërdrejt detyrat që lidhen me ofrimin aktual të një shërbimi apo shërbimeve. Nuk do të kërkohet testi i nevojave ekonomike.

Specialistët: janë persona që posedojnë njohuri të rralla thelbësore për shërbimin, pajisjet kërkimore, teknikat ose menaxhmentin e një ndërmarrje. Në vlerësimin e njohurive të tilla do të merren parasysh jo vetëm njohuritë specifike për themelimin, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë kualifikimi që i referohet një lloji të punës ose tregtisë që kërkon njohuri specifike teknike, duke përfshirë anëtarësimin në një profesion të akredituar. Nuk do të kërkohet testi i nevojave ekonomike.

(ii) Vizitorët e biznesit (VB)

Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i kategorive të mëposhtme është i lejuar pa aplikimin e testit të nevojave ekonomike për një periudhë deri në 90 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore:

- (a) Shitësit e shërbimeve - persona që nuk banojnë në **PV**, të cilët janë përfaqësues të një furnizuesi të shërbimit dhe kërkojnë hyrje të përkohshme me qëllim të negocimit dhe kontraktimit për shitjen e shërbimeve, por nuk janë të angazhuar vetë në shitjen e drejtpërdrejtë te publiku i gjerë ose në furnizimin e shërbimeve; dhe
- (b) Personat përgjegjës për krijimin e pranisë komerciale - menaxherët të cilët janë përgjegjës për krijimin në **PV** të një pranie komerciale të një ofruesi të shërbimeve të një Pale tjetër dhe të cilët nuk janë të angazhuar në shitjen e drejtpërdrejtë ose në ofrimin e shërbimeve nëse ofruesi i shërbimit nuk ka prani tjetër komerciale në **PV**.

(iii) Furnizuesit e shërbimeve kontraktuale (CSS)

Hyrja do t'u lejohet personave fizikë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në baza të përkohshme si punonjës i një personi juridik pa prani komerciale në **PV**, në varësi të kushteve të mëposhtme:

- a) Personi juridik ka marrë një kontratë shërbimi, për një periudhë që nuk kalon 12 muaj nga një konsumator final në **PV**, përmes një procedure që garanton karakterin e mirëfilltë (bona fide) të kontratës;
- b) Kontrata e shërbimit është në përputhje me ligjet e **PV**;
- c) Personi fizik që kërkon hyrjen duhet të ofrojë shërbime të tilla si një punonjës i personit juridik që furnizon shërbimin për të paktën një vit menjëherë para hyrjes së tillë;
- d) Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm do të jetë për një periudhë kumulative jo më shumë se 90 ditë në çdo periudhë 12 mujore ose për kohëzgjatjen e kontratës, cilado që është më e shkurtër;
- e) Personi fizik duhet të ketë: (a) një diplomë universitare ose një kualifikim teknik që tregon njohuri të një niveli ekuivalent;¹ (b) kualifikime profesionale kur kërkohen për ushtrimin e një aktiviteti në sektorin përkatës në përputhje me ligjet, rregulloret ose kërkesat e **PV**; dhe, (c) të paktën 3 vite përvojë profesionale në këtë sektor;
- f) Angazhimi lidhet vetëm me aktivitetin e shërbimit që është subjekt i kontratës; nuk jep të drejtën për të ushtruar një profesion në **PV**;
- g) Numri i personave që mbulohen nga kontrata e shërbimit nuk duhet të jetë më i madh se sa që është e nevojshme për të përmbushur kontratën;
- h) Nuk do të kërkohet testi i nevojave ekonomike; dhe
- i) Kontrata e shërbimit duhet të merret në një nga aktivitetet e mëposhtme:

Shërbime ligjore;

Shërbime të kontabilitetit dhe libërmbajtjes;

Shërbime arkitekturore, të planifikimit urban dhe shërbime të arkitekturës së peizazhit;

Shërbime inxhinierike, shërbime inxhinierike të integruara;

Shërbime kompjuterike dhe të ngjashme;

Reklama;

Shërbime të konsulencës së menaxhmentit;

Shërbime në lidhje me konsulencën e menaxhmentit;

Shërbime të testimin dhe analizës teknike;

Shërbime të ndërlidhura të konsulencës shkencore dhe teknike;

Shërbime të përkthimit;

Shërbime mjedisore; dhe

Instalim dhe mirëmbajtje e makinerive ose pajisjeve.

¹ Kur diploma ose kualifikimi nuk është marrë në **PV**, kjo e fundit mund të vlerësojë nëse është ekuivalente me një diplomë universitare të marrë në **PV**.

B. ANGAZHIME SPECIFIKE

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
1. SHËRBIMET E BIZNESIT		
Shërbime juridike (CPC 861)		
Shërbime juridike (861) - Konsulenca mbi juridiksionin vendor, ligjin e huaj si dhe të drejtën ndërkombëtare (pjesë e CPC 861) (përveç noterëve, përmbauesve privatë dhe dokumentacionit ligjor dhe shërbimeve të certifikimit të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të ngarkuara me funksione publike) PII, PIII, PV, PVI, PVII	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime juridike (861) (përveç noterëve, përmbauesve privatë dhe dokumentacionit ligjor dhe shërbimeve të certifikimit) PI	Mënyrat 1, 2, 3, 4 – Asnjë, përveç avokatëve të një pale tjetër nuk duhet të shoqërohet në gjykatë nga një avokat i PI .	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime juridike (861) – Përveç konsulencës mbi juridiksionin vendor, ligjin e huaj si dhe të drejtën ndërkombëtare PIV	Mënyra 1 - Pa kufizim, përveç hartimit të dokumenteve ligjore; Mënyra 2 - Asnjë; Mënyra 3 - Asnjë, përveç se shërbimet ligjore mund të ofrohen vetëm nëpërmjet personave juridikë të inkuorporuar në PIV . Mënyra 4 - Asnjë, përveç se një avokat i licencuar mund t'i ofrojë të gjitha shërbimet juridike, përveç përfaqësimit në procedurën penale. Përfaqësimi në procedurën penale lejohet vetëm për avokatët nën betim.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë;
Shërbime ligjore (861) - Konsulenca mbi juridiksionin vendor, ligjin e huaj si dhe të drejtën ndërkombëtare; (Pjesë e CPC 861) PIV	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë, përveç kërkesave të kombësisë për avokatët dhe noterët nën betim.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë, përveç siç tregohet në kolonën e qasjes në treg.
Shërbime të kontabilitetit, auditimit dhe libërmbajtjes (CPC 862) PI, PV, PIV	Mënyrat 1, 2, 3, 4 – Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të kontabilitetit, auditimit dhe libërmbajtjes (CPC 862) PII, PVI, PVII	Mënyra 1 - Asnjë, përveç që raportet zyrtare të auditimit duhet të konfirmohen nga një firmë auditimi e regjistruar në juridiksionin vendor dhe të nënshkruhen nga një auditor i licencuar. Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë, përveç siç tregohet në kolonën e qasjes në treg.

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Shërbime të auditimit (pjesë e CPC 862) PIII	Mënyrat 1, 2 – Kërkohe lidhja e një kontrate me kompaninë vendore të auditimit. Kompania e një Pale tjetër duhet të jetë e regjistruar në juridiksionin e saj për ofrimin e shërbimeve të auditimit. Mënyrat 3, 4 - Asnjë	Mënyra 1, 2 - Një kompani auditimi e një Pale tjetër, e cila nuk është e regjistruar në PIII , por është e regjistruar për të kryer auditime në juridiksionin ku është vendosur zyra e saj kryesore, mund të kryejë auditime në PIII vetëm në bazë të kontratës, në bashkëpunim me një kompani vendore të auditimit. Mënyrat 3, 4 - Asnjë
Shërbime tatimore (CPC 863) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime arkitekturore (CPC 8671) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime inxhinierike (CPC 8672) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime inxhinierike të integruara (CPC 8673) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të planifikimit urban dhe të arkitekturës së peizazhit (CPC 8674) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime mjekësore dhe dentare (me përjashtim të institucioneve të shëndetit publik) (CPC9312) PI, PII, PIII, PV, PVI, PVII	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime mjekësore dhe dentare (me përjashtim të institucioneve të shëndetit publik) (CPC9312) PIV	Mënyrat 1, 2, 4 - Asnjë Mënyra 3 – Për praktikimin e profesionit mjekësor nga persona të një Pale tjetër nevojitet leja nga autoritetet lokale shëndetësore bazuar në nevojat ekonomike për mjekët dhe dentistët në një rajon të caktuar.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë, përveç siç tregohet në kolonën e qasjes në treg

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Shërbime veterinarë (CPC 932), me përjashtim të institucioneve publike Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të mamive, infermierëve, fizioterapeutëve, personelit paramjekësorë (CPC 93191) me përjashtim të institucioneve shëndetësore publike Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime kompjuterike dhe të ngjashme (CPC 84) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të hulumtimit dhe zhvillimit (CPC 851-853) PI, PII, PIV, PV, PVI, PVII PIII: përveç hulumtimeve në fushën e identitetit historik dhe kulturor të popullsisë së PIII dhe kombësitë që jetojnë në PIII .	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të patundshmërive (CPC 821 & 822) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të qirasë pa operator (CPC 83) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Dhënia me qira e pajisjeve të regjistrimit të studiove (CPC 83109)** Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të qirasë në lidhje me videokasetat e para-regjistruara dhe disqet optike për përdorim në pajisjet e argëtimit shtëpiak (CPC 83202) PIII	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të reklamimit (CPC 871) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Hulumtimi i tregut dhe shërbime të studimit të opinionit publik (CPC 864) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të konsulencës së menaxhmentit (CPC 865) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Shërbime në lidhje me konsulencën e menaxhmentit (CPC 866) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të testimit dhe analizës teknike (CPC 8676) (Duke përjashtuar shërbimet që lidhen me lëshimin e certifikatave të detyrueshme dhe dokumenteve të ngjashme zyrtare, përveç atyre për të cilat parashihet njohja e vlefshmërisë së certifikatave ose dokumenteve të një Pale tjetër). Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të ndërlidhura me bujqësinë, gjuetinë dhe pylltarinë (CPC 881) PI, PIII, PIV	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime këshilluese të ndërlidhura me bujqësinë dhe pylltarinë (pjesë e CPC 881) PII, PV, PVI, PVII	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet këshilluese dhe të konsulencës në lidhje me gjuetinë (pjesë e CPC 881) PII, PV, PVI, PVII	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të ndërlidhura me peshkimin (CPC 882) PI, PIII, PIV	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime këshilluese dhe të konsulencës në lidhje me peshkimin (pjesë e CPC 882) PII, PV, PVI, PVII	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet që ndërlidhen me minierat (CPC 883) Përgatitja e vendit për miniera (CPC 5115) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të ndërlidhura me prodhimin (CPC 884) Shërbime të ndërlidhura me prodhimin e produkteve metalike, makinerive dhe pajisjeve (CPC 885) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Shërbimet këshilluese dhe të konsulencës të ndërlidhura me shpërndarjen e energjisë (pjesë e CPC 887) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të vendosjes së personelit dhe furnizimit (CPC 872) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të ndërlidhura të konsulencës shkencore dhe teknike (CPC 8675) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve (CPC 633+8861 to 8866) Mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe motorëve të borës (CPC 6122) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të pastrimit të ndërtesës (CPC 874) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime fotografike (CPC 875) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të paketimit (CPC 876) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Printimi dhe botimi (88442), duke përfshirë printimin dhe botimin e Gazetës Zyrtare Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime për kuvende – Shërbime të planifikimit, menaxhimit dhe marketingut për kuvende dhe ngjarje të ngjashme (CPC 87909*) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime përkthimi dhe interpretimi (CPC 87905) duke përfshirë shërbimet e përkthyesve nën betim Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të dizajnit të specializuar (CPC 87907*) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Shërbime për rregullime të flokëve dhe berberë (CPC 97021) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
2. SHËRBIMET E KOMUNIKIMIT		
Shërbime postare dhe korriere² (CPC 68)		
A. Shërbime postare (CPC 6811)		
<p>(i) Shërbime postare lidhur me letrat (CPC 68111): shërbime të grumbullimit, transportit dhe dërgimit të gazetave, revistave dhe botimeve periodike, qoftë në destinacione vendore apo të huaja, përveç atyre të kryera në bazë të një detyrimi të shërbimit universal.</p> <p>(ii) Shërbime të grumbullimit, transportit dhe dërgimit të letrave, broshurave, fletëpalosjeve dhe materialit të ngjashëm të printuar, qoftë në destinacione vendore apo të huaja, të ndryshme nga ato që janë bërë nën një detyrim të shërbimit universal, me përjashtim të artikujve me më pak peshë se 350 gramë dhe çmimi i të cilave është pesë herë më i vogël se tarifa bazë publike, duke përjashtuar shërbimin e postës së regjistruar të përdorur në procedurën gjyqësore ose administrative.</p> <p>(iii) Shërbime postare lidhur me kolutë (CPC 68112): shërbime të grumbullimit, transportit dhe dërgimit të kolive dhe pakove, qoftë në destinacione vendore apo të huaja, përveç atyre të kryera në bazë të një detyrimi të shërbimit universal, duke përjashtuar sendet më pak se 350 gramë në peshë dhe çmimi i të cilave është pesë herë më i vogël se tarifa bazë publike, duke përjashtuar shërbimin e postës së regjistruar të përdorur në procedurën gjyqësore ose administrative.</p>	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë

² Bazuar në versionin 2 të CPC (Publikimi i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Të gjitha Palët e CEFTA-s		
<p>Shërbime korriere (CPC 6812) (i) Shërbime të grumbullimit, transportit dhe dërgimit, goftë në destinacione vendore ose të huaja, të letrave, kolive dhe pakove, të kryera me korrier dhe duke përdorur një ose më shumë mënyra të transportit, përveç atyre të kryera nën një detyrim të shërbimit universal. (ii) Shërbime të dërgesave (messenger services) ofrohen nga korrierët me biçikleta. (iii) Shërbime të dërgimit lokal të artikujve të tillë si ushqimi dhe blerjet e tjera (CPC 6813). Të gjitha Palët e CEFTA-s</p>	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të Telekomunikacionit dhe Furnizimit të Informacionit		
Shërbime të telefonisë dhe shërbime tjera të telekomunikacionit (CPC 841)³		

³ Bazuar në versionin 2 të CPC (Publikimi i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Shërbime të transportuesit (CPC 8411) Shërbime të telefonisë fikse (CPC 8412) Shërbime të telekomunikacionit celular (CPC 8413) Shërbime të rrjetit privat (CPC 8414) Shërbime të transmetimit të të dhënave (CPC 8415) Shërbime tjera të telekomunikacionit (CPC 8419) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të telekomunikacionit në internet (CPC 842)⁴ Shërbimet e shtyllës së internetit (CPC 8421) Shërbimet e qasjes në internet (CPC 8422) Shërbime tjera të telekomunikacionit në internet (CPC 8429) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Përmbajtja në internet (CPC 843)⁵ Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
3. SHËRBIME TË NDËRTIMIT DHE SHËRBIME TË NDËRLIDHURA INXHINIERIKE		
Punimet para-ngritjes në vendet e ndërtimit (CPC 511) Punime ndërtimore për ndërtesa (CPC 512) Punime ndërtimore për inxhinieri civile (CPC 513) Montimi dhe ngritja e konstruksioneve të parafabrikuara (CPC 514) Punime ndërtimore për punë të posaçme (CPC 515) Punime instalimi (CPC 516) Punime për kompletimin dhe përfundimin e ndërtesës (CPC 517) Shërbime të marrjes me qira e në lidhje me pajisjet për ndërtimin ose prishjen e ndërtesave ose punimet e inxhinierisë civile, me operatorin (CPC 518) Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë

⁴ Bazuar në versionin 2 të CPC (Publikimi i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

⁵ Bazuar në versionin 2 të CPC (Publikimi i Kombeve të Bashkuara ST/ESA/STAT/SER.M/77/Ver.2).

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
4. SHËRBIME TË SHPERNDARJES (Versioni 2 i CPC, Seksionet 61 dhe 62, duke përfshirë tregtinë e eksplozivëve, armëve dhe municionit dhe, për PVI, tregtinë e organizmave të modifikuar gjenetiki)		
<u>Shërbime të tregtisë me shumicë</u> Shërbimet e tregtisë me shumicë, përveç me tarifë ose kontratë Shërbime të tregtisë me shumicë me tarifë ose kontratë <u>Shërbime të tregtisë me pakicë</u> Shërbime të tregtisë me pakicë në dyqane jo të specializuara Shërbime të tregtisë me pakicë në dyqane të specializuara Shërbime të tregtisë me pakicë përmes porosisë me postë apo në internet Shërbime të tjera të tregtisë me pakicë jo në dyqane Shërbime të tregtisë me pakicë me tarifë ose kontratë Të gjitha Palët e CEFTA-s	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
5. SHËRBIME ARSIMORE (Vetëm shërbime të financuara privatisht)		
Shërbime të arsimit fillor (CPC 921) Shërbime të arsimit të mesëm (CPC 922) Shërbime të arsimit të lartë (CPC 923) Arsimi i të rriturve (CPC 924) Shërbime tjera arsimore (CPC 929) PI, PII, PIV, PV, PVI, PVII PIII: Përfshihen shërbimet e arsimit fillor (CPC 921)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
6. SHËRBIME MJEDISORE		
A. Menaxhimi i ujërave të zeza (shërbimet e ujërave të zeza korrespondojnë me shërbimet e kanalizimit) CPC 9401)		

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
<p>B. Menaxhimi i mbeturinave të ngurta/të rrezikshme</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shërbime të hedhjes së mbeturinave (CPC 9402) - Shërbime sanitare dhe të ngjashme (CPC 9403) <p>C. Mbrojtja e ajrit dhe klimës së ambientit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shërbimet e pastrimit të gazeve të shkarkuara (CPC 9404) <p>D. Rregullimi dhe pastrimi i tokës dhe ujërave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajtimi, rregullimi i tokës dhe ujit të kontaminuar/ndotur (pjesë e CPC 9406) Korrespondon me pjesë të shërbimeve të mbrojtjes së natyrës dhe të peizazhit. <p>E. Zvogëlimi i zhurmës dhe dridhjes (CPC 9405)</p> <p>F. Mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shërbime të mbrojtjes së natyrës dhe peizazhit (pjesë të CPC 9406 nuk mbulohen nën D) <p>G. Shërbime tjera mjedisore (CPC 9409)</p> <p>H. Shërbime konsulente mjedisore (CPC 83931)</p> <p>Të gjitha palët e CEFTA-s</p>	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
7. SHËRBIME FINANCIARE		
Shërbime të sigurimeve dhe të ndërlidhura me sigurimet (CPC 812) PI		
Shërbime të sigurimit për jetë, aksidente dhe shëndet, (CPC 8121)	Mënyra 1 – Pa kufizim, (Asnjë për sigurimin e jorezidentëve në PI dhe për investime të huaja). Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyra 1 - Pa kufizim, (Asnjë për sigurimin e jorezidentëve në PI dhe për investime të huaja) Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimit jojetë, (CPC 8129)	Mënyra 1 - Pa kufizim, (Asnjë për sigurimin e jorezidentëve në PI dhe për investime të huaja)	Mode 1 - Pa kufizim, (Asnjë për sigurimin e jorezidentëve)

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
	Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	në PI dhe për investime të huaja) Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimit detar, të aviacionit dhe transportit (CPC 81293)	Mënyrat 1, 2, 4 - Asnjë Mënyra 3 - Asnjë, përveç se personi juridik i një Pale tjetër duhet të ketë ofruar shërbime sigurimi në juridiksionin e tij vendor për të paktën 5 vite në mënyrë që të themelohet ose autorizohet për të operuar ose për të ofruar shërbime në PI . Për të gjitha format e pranisë komerciale, përfaqësuesi i përgjithshëm i kompanisë duhet të banojë në PI .	Mënyrat 1, 2, 3, 4, - Asnjë, përveç siç tregohet në kolonën e qasjes në treg
Risigurimi dhe retrocesioni, (CPC 81299*)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime ndihmëse të sigurimit (duke përfshirë shërbimet e brokerimit dhe agjencisë) (CPC 8140)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Veprimtaria aktuariale dhe zgjidhja e kërkesave rregullohen me ligj. Pjesa tjetër e këtyre shërbimeve nuk janë të rregulluara (pjesë e CPC 8140)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimeve dhe të ndërlidhura me sigurimet (CPC 812) PII		
Shërbime të sigurimit për jetë, aksidente dhe shëndet (CPC 8121) Shërbime të sigurimit jojetë (CPC 8129) Risigurimi dhe retrocesioni (CPC 81299*) Shërbime ndihmëse të sigurimit (duke përfshirë shërbimet e brokerimit dhe agjencisë) (CPC 8140)	Mënyra 1 - Asnjë, si ndërmjetës, për sigurimin e transportit detar të udhëtarëve (të planifikuar ose jo të planifikuar), me një sigurim të tillë për të mbuluar një ose të gjitha këto që vijnë: pasagjerët që transportohen, automjeti që transporton pasagjerët dhe çdo detyrim që rrjedh prej tyre, si dhe mallrat në transit ndërkombëtar. Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyra 1 - Asnjë Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimeve dhe të ndërlidhura me sigurimet (CPC 812)		

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
PIII		
Shërbime të sigurimit për jetë, aksidente dhe shëndet, (CPC 8121)	Mënyrat 1, 2 – Pa kufizim Mënyra 3 - Asnjë, përveç se një kompani sigurimi duhet të themelohet si një shoqëri aksionare në mënyrë që të ofrojë shërbime të sigurimit jetë. Mënyra 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2 – Pa kufizim Mënyrat 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimit jojetë, (CPC 8129)	Mënyra 1 - Asnjë për sigurimin detar dhe të aviacionit dhe sigurimin e shitur për automjetet e transportit të licencuara për qëllime komerciale. Pa kufizim për shërbime tjera sigurimi. Mode 2 - Asnjë për sigurimin detar dhe të aviacionit dhe sigurimin e shitur për automjetet e transportit të licencuara për qëllime komerciale. Pa kufizim për shërbime tjera sigurimi. Mënyra 3 – Duhet të krijohet një shoqëri aksionare e sigurimit në PIII që të ofrojë shërbime të sigurimit jojetë. Mënyra 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Risigurimi dhe retrocesioni (CPC 81299*)	Mënyrat 1, 2, 4 - Asnjë Mënyra 3 - Duhet të krijohet një kompani sigurimi si një shoqëri aksionare në mënyrë që të ofrojë shërbime sigurimi dhe risigurimi.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime ndihmëse të sigurimit (duke përfshirë shërbimet e brokerimit dhe agjencisë) (CPC 8140)	Mënyrat 1, 2, 4 - Asnjë Mënyra 3 - Duhet të krijohet një kompani brokerimi dhe agjenci e specializuar e sigurimeve si shoqëri aksionare për të siguruar ndërmjetësimin e sigurimeve dhe përfaqësimin në shërbimet e sigurimeve.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimeve dhe të ndërlidhura me sigurimet (CPC 812)		
PIV		
Shërbime të sigurimit për jetë, aksidente dhe shëndet, (CPC 8121) Shërbime të sigurimit jojetë (CPC 8129)		

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Risigurimi dhe retrocesioni (CPC 81299*) Shërbime ndihmëse të sigurimit (duke përfshirë shërbimet e brokerimit dhe agjencisë) (CPC 8140)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimeve dhe të ndërlidhura me sigurimet (CPC 812) PV⁶		
Shërbime të sigurimit për jetë, aksidente dhe shëndetësi (CPC 8121)	Mënyra 1 - Pa kufizim, përveç ofrimit të sigurimit jetë për shtetasit e një Pale tjetër - Asnjë. Mënyrat 2, 3, 4 – Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimit jojetë (CPC 8129)	Mënyra 1 - Pa kufizim, përveç për sigurimin e pasurisë së shtetasve të një Pale tjetër, si dhe sigurimin e rreziqeve që kanë të bëjnë me transportin detar dhe aviacionin komercial dhe lansimin dhe mallrat në hapësirë (duke përfshirë satelitët), me një sigurim të tillë për të mbuluar një ose të gjitha këto që vijojnë: mallrat që transportohen, mjetet që transportojnë mallrat dhe çdo detyrim që rrjedh prej tyre, dhe mallrat në transit ndërkombëtar. Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 – Asnjë
Risigurimi dhe retrocesioni (CPC 81299*)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime ndihmëse të sigurimit (duke përfshirë shërbimet e brokerimit dhe agjencisë) (CPC 8140)	Mënyra 1 - Pa kufizim, përveç sigurimit jetë për shtetasit e një Pale tjetër, sigurimin e pronës së shtetasve të një Pale tjetër, si dhe sigurimin e rreziqeve që kanë të bëjnë me transportin detar dhe aviacionin komercial dhe lansimin dhe mallrat në hapësirë (duke përfshirë satelitët), me një sigurim të tillë për të mbuluar një ose të gjitha këto që vijojnë: mallrat që transportohen, mjetet që transportojnë mallrat dhe çdo detyrim që rrjedh prej tyre, dhe mallrat në transit ndërkombëtar. Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimeve dhe të ndërlidhura me sigurimet, CPC 812 PVI⁷		

⁶ Shoqëritë e sigurimit të një Pale tjetër kërkohet të krijojnë filiale të cilat duhet të inkorporohen si shoqëri aksionare në PV. Një kompani për ndërmjetësim në sigurime dhe agjenci për ofrimin e shërbimeve të tjera mund të krijohet si një shoqëri aksionare ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në PV.

⁷ Kompanitë e sigurimeve dhe kompanitë e risigurimit të një Pale tjetër duhet të themelojnë filiale të cilat duhet të inkorporohen si shoqëri aksionare në territorin e PVI. Në mënyrë të veçantë, kompania për brokerimin e sigurimeve, ose për shërbimet e agjencive të sigurimit, ose për shërbimet tjera të sigurimit duhet të inkorporohen si shoqëri aksionare ose shoqëri

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
Shërbime të sigurimit për jetë, aksidente dhe shëndet (CPC 8121)	Mënyrat 1, 2 - Pa kufizim, përveç sigurimit për: (i) shtetasit e një Pale tjetër në PVI (me përjashtim të sigurimit të detyrueshëm të përshkruar për personat e tillë në PVI); (ii) punonjësit e kompanive në PVI të themeluara për kryerjen e një veprimtarie jashtë vendit, në pronësi të personave vendor ose në pronësi të përbashkët nga personat vendor dhe personat e një Pale tjetër, nëse kjo kërkohet nga juridiksioni i Palës tjetër ose nëse parashikohet shprehimisht në aktin e themelimit të këtyre kompanive; Mënyra 3 - Asnjë, Mënyra 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2 - Pa kufizim, përveç siç tregohet në kolonën e qasjes në treg Mënyra 3 - Asnjë Mënyra 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimit jojetë (CPC 8129)	Mënyrat 1, 2 – Pa kufizim, përveç: - sigurimi i rreziqeve që kanë të bëjnë me transportin detar, aviacionin komercial, lansimin dhe mallrat në hapësirë (duke përfshirë satelitët); me një sigurim të tillë për të mbuluar një ose të gjitha këto si më poshtë: mallrat që transportohen; mjeti që transporton mallrat dhe çdo detyrim që rrjedh prej saj - sigurimi i mallrave në transit ndërkombëtar Mënyra 3 - Asnjë, Mënyra 4 - Asnjë	Mënyra 1, 2 - Pa kufizim, përveç siç tregohet në kolonën e qasjes në treg Mënyra 3 - Asnjë Mënyra 4 - Asnjë
Risigurimi dhe retrocesioni (CPC 81299*)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet ndihmëse të sigurimit (duke përfshirë shërbimet e brokerimit dhe agjencisë) (CPC 8140)	Mënyrat 1, 2 - Pa kufizim, përveç shërbimeve të sigurimit për të cilat janë marrë angazhimet nën nënsektorët (i) dhe (ii) CPC 8121 dhe CPC 8129 (përveç CPC 81299). Mënyra 3 - Asnjë Mënyra 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2 - Pa kufizim, përveç siç tregohet në kolonën e qasjes në treg Mënyra 3 - Asnjë Mënyra 4 - Asnjë
Shërbime të sigurimeve dhe të ndërlidhura me sigurimet, CPC 812		

me përgjegjësi të kufizuar. Degët e kompanive të themeluara komercialisht jashtë **PVI** për furnizimin e shërbimeve të risigurimit dhe të sigurimeve do të lejohen 5 vite pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit. Të paktën një anëtar i çdo bordi mbikëqyrës të kompanisë së sigurimit dhe së paku një anëtar i secilit bord ekzekutiv të kompanisë së sigurimit duhet të ketë njohuri aktive për gjuhën e **PVI** dhe vendbanim të përhershëm në territorin e **PVI**. Skemat e sigurimit të detyrueshëm në lidhje me sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore shtetërore dhe planet shtetërore të pensionimit, si dhe skemat e sigurimit të detyrueshëm të depozitave përjashtohen nga angazhimet e qasjes në treg dhe të trajtimit kombëtar të përfshira në këtë orar. Pranimi i produkteve të reja të sigurimit mund të kontrollohet për arsye të kujdesit paraprak.

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
PVII		
Shërbime të sigurimit për jetë, aksidente dhe shëndet, (CPC 8121)	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 – Asnjë
Shërbime të sigurimit jojetë (CPC 8129) (Përveç rasteve të sigurimit të rreziqeve të lidhura me transportin detar ose ajror dhe kur rreziku nuk mbulohet nga kompania vendore ose dega e kompanisë së një Pale tjetër, e cila ushtron veprimtarinë e saj në PVII (Kompania duhet të jetë e regjistruar në PVII).	Mënyra 1 – Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyra 1 – Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë
Risigurimi dhe retrocesioni (CPC 81299*) (Vetëm për rreziqet e siguruar nga kompanitë e sigurimeve të një Pale tjetër dhe për rreziqet që risiguresit vendas nuk janë në gjendje t'i mbulojnë. Bazuar në rregullat e brendshme të Bankës Qendrore të PVII , kompanitë e sigurimeve nuk mund të mbajnë rrezik për një ngjarje që tejkalon 10% të kapitalit të tyre.)	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet ndihmëse të sigurimit (duke përfshirë shërbimet e brokerimit dhe agjencisë) (CPC 8140)	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet bankare dhe të tjera financiare (duke përjashtuar sigurimet)		
PI		
a. Pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku (CPC 81115-81119) b. Kreditimi i të gjitha llojeve, përfshirë, ndër të tjera, kreditë konsumatorë, kreditë hipotekare, faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare (CPC 81113) c. Lizingu financiar (CPC 81112) d. Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave (CPC 81339) e. Garancitë dhe angazhimet (CPC 81199)	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
<p>f. Tregtimi për llogari personale ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg jashtë bursës (OTC) ose ndryshe, i:</p> <ul style="list-style-type: none"> - instrumenteve të tregut të parasë (çeçet, faturat, certifikatat e depozitave, etj.) - këmbimit valutor - produkteve derivative, duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes dhe kontrata me opsione - instrumenteve të normës së këmbimeve dhe normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje swap dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen, etj. - letrave me vlerë të transferueshme - instrumenteve të tjera të negociueshme dhe asetëve financiare, përfshirë shufra ari ose argjendi 	<p>Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4, - Asnjë</p> <p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p> <p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p> <p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p> <p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p> <p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>
<p>g. Pjesëmarrja në emetimet e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, përfshirë sigurimin dhe plasimin si agent (qoftë në mënyrë publike apo private) dhe ofrimin e shërbimit lidhur me këto emetime (CPC 8132)</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>
<p>h. Brokerimi i parave</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>
<p>i. Menaxhimi i asetëve të tilla si menaxhimi i parave ose i portofolit, të gjitha format e menaxhimit të investimeve kolektive, menaxhimi i fondeve të pensionit dhe shërbimet e mbajtjes, depozitimit dhe trustit</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>
<p>k. Këshillime dhe shërbime të tjera ndihmëse financiare duke përfshirë referencën dhe analizën e kredisë, hulumtimin dhe këshillimin për investime dhe portofol, këshilla për blerjet dhe ristrukturimin dhe strategjinë e korporatave CPC 8131 or 8133)</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>	<p>Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë</p>

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
I. Sigurimi dhe transferimi i informacionit financiar, përpunimit të të dhënave financiare dhe softuerëve të ndërlidhur nga ofruesit e shërbimeve të tjera financiare (CPC 8131)	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet bankare dhe të tjera financiare (duke përjashtuar sigurimet) PII		
<p>a. Pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku</p> <p>b. Kreditimi i të gjitha llojeve, përfshirë, ndër të tjera, kreditë konsumatore, kreditë hipotekare, faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare</p> <p>c. Lizingu financiar</p> <p>d. Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave</p> <p>e. Garancitë dhe zotimet</p> <p>f. Tregtimin për llogari personale ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg jashtë bursës (OTC) ose ndryshe</p> <p>g. Pjesëmarrja në emetimet e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, përfshirë sigurimin dhe plasimin si agjent (qoftë në mënyrë publike apo private) dhe ofrimin e shërbimit lidhur me këto emetime</p> <p>h. Brokerimi i parave</p> <p>i. Menaxhimi i aseteve, të tilla si menaxhimi i parasë ose i portofolit, të gjitha format e menaxhimit të investimeve kolektive, menaxhimin e fondit të pensioneve dhe shërbimet e mbajtjes, depozitimit dhe trustit</p>	<p>Mënyra 1 – Pa kufizim</p> <p>Mënyra 2 - Asnjë</p> <p>Mënyra 3 - Asnjë, përveç se krijimi i një kompanie të specializuar të menaxhimit kërkohet të kryejë aktivitetet e menaxhimit të njësisive të besimit dhe kompanive të investimit.</p> <p>Mënyra 4 - Asnjë</p>	<p>Mënyra 1 - Pa kufizim</p> <p>Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë</p>
k. Shërbime këshillimore dhe shërbime të tjera ndihmëse financiare duke përfshirë referencën dhe analizën e kredisë, hulumtimin dhe këshillimin për investime dhe portofol, këshilla për blerjet dhe ristrukturimin dhe strategjinë e korporatave		

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
I. Sigurimi dhe transferimi i informacionit financiar, përpunimit të të dhënave financiare dhe softuerëve të ndërlidhur nga ofruesit e shërbimeve të tjera financiare.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
Shërbimet bankare dhe të tjera financiare (duke përjashtuar sigurimet) PIII		
	Vetëm një person juridik i themeluar në PIII mund të ofrojë shërbime bankare dhe shërbime tjera financiare. Banka e një pale tjetër mund të ofrojë shërbime bankare duke krijuar një bankë ose degë në PIII . Banka duhet të krijohet si shoqëri aksionare. Shtëpi brokerimi, fonde të mbyllura të investimeve, kompani të menaxhimit të fondeve dhe Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë do të krijohen si shoqëri aksionare. Shtëpitë e brokerimit duhet të krijohen nga të paktën dy persona vendor, juridikë ose fizikë, të një pale tjetër. Ky kufizim nuk zbatohet nëse shtëpitë e brokerimit krijohen nga një bankë, bankë e kursimeve ose një kompani sigurimi. Vetëm shtëpitë e brokerimit, bankat, kompanitë e sigurimeve dhe kompanitë e menaxhimit të fondeve mund të jenë themelues të Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë. Personat fizikë dhe juridikë të një pale tjetër nuk lejohen të krijojnë banka të kursimeve dhe këmbimore	
a. Pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku	Mënyrat 1, 2 – Pa kufizim Mënyra 3 - Pa kufizim, me përjashtim të bankave dhe bankave të kursimeve. Bankat e kursimeve janë të autorizuara të ofrojë shërbime të depozitave vetëm për personat fizikë. Mënyra 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
b. Kreditimi i të gjitha llojeve, përfshirë, ndër të tjera, kreditë konsumatore, kreditë hipotekare, faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare.	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyra 2 - Asnjë Mënyra 3 - Për banka: Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
	Për banka të kursimeve: Dhënia e kredive për personat juridikë që tejkalojnë 150% të kapitalit të garantuar të bankave të kursimit duhet të ofrohet vetëm nëpërmjet bankës. Për personat e tjerë juridikë: Mund të japin kredi vetëm për persona të tjerë juridikë. Mënyra 4 - Asnjë	
c. Lizingu financiar	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
d. Të gjitha shërbimet e pagesave dhe shërbimet e transferimit të parave	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyra 2 - Asnjë për transaksionet aktuale dhe investimet direkte. Mënyra 3 - Ky lloj shërbimesh mund të ofrohet vetëm nga bankat. Mënyra 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
e. Garancitë dhe zotimet	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyrat 2, 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
f. Tregtimi për llogari personale ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg jashtë bursës (OTC) ose ndryshe, i:		
- instrumenteve të tregut të parave (çeqe, fatura, certifikata të depozitave, etj.)	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyra 2 - Pa kufizim. Asnjë për banka. Asnjë për tregtimin me çeqe dhe kambiale. Mënyra 3 - Ky lloj shërbimesh mund të ofrohet vetëm nga bankat dhe bankat e kursimeve. Mënyra 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
- këmbimit valutor ⁸	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyra 2 - Pa kufizim. Asnjë deri në nivelin e përcaktuar nga qeveria. Mënyra 3 - Ky lloj shërbimesh mund të ofrohet vetëm nga bankat dhe këmbimoret.	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë

⁸ Mbulon shërbimet e këmbimit valutor të ofruar nga këmbimoret te personat fizikë.

SEKTORI OSE NËNSEKTORI	KUFIZIMET NË QASJEN NË TREG	KUFIZIMET NË TRAJTIMIN KOMBËTAR
	Mënyra 4 - Asnjë	
- produkteve derivative duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kontrata të së ardhmes dhe kontrata me opsione	Mënyra 1 - Pa kufizim Mënyra 2 - Pa kufizim. Asnjë për banka. Mënyrat 3, 4 - Asnjë	Mënyrat 1, 2, 3, 4 - Asnjë
